

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**NPG COMPANY SH.P.K.**

Sot, më datë 04.11.2021

**NIKOLLAJ GJATA**, lindur ne Bilisht, i datëlindjes 06.12.1959, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi Karte identiteti F91206076L ka përpiluar këtë akt themelimi të shoqërisë tregtare **NPG COMPANY SH.P.K.**, me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

Shoqëria Tregtare **NPG COMPANY SH.P.K.**, themelohet në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", (këtu e më poshtë **Shoqëria**).

Shoqëria është një person juridik Shqiptar.

**NENI 2**

**Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin **NPG COMPANY SH.P.K.** Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

**NENI 3**

**Objekti i veprimtarisë**

Veprimtaria e shoqërisë është:

Shërbime ne fushen e pasurive të paluajtshme. Agjensi immobiliare dhe shërbime plotësuese. Menaxhimi i pasurive te paluajtshme, shitje-blerje, pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme, dhenie me qira, investime, vlerësim i pronës, etj.

-Konsulence dhe menaxhim biznesi, analizim te dhenash per te vete dhe te trete

-Transporti kombetar dhe nderkombetar i mallrave ne rruge tokesore, e kombinuar me detare/ hekurudhere, autotransport mallrash tokësor, e kombinuar me anije dhe hekurudhë, shperndarje e mallrave per llogari te te treteve, ushtrimin e spedicioneve kombetare/ dhe nderkombetare te mallrave me cfaredo lloj mjeti, magazinim dhe/ose menaxhim te magazinave dhe per llogari te te treteve, statusit e rregulloreve, për një rritje te qëllimeve shoqërore, teknike, ekonomike e pasurore, menaxhimin e oficines së riparimeve të mjeteve në pronesi të kompanise dhe/ose me qira, promovimin/studimin e merkates se sektorit; promovimin/berjen e kërkimeve në merkatën e sektorit; studimin, promovimin, kryerjen e riorganizimit e

menaxhimin e magazinave për të tretë ne vecanti me referencën e lay-out, për shpërndarjen e brëndshme te mallrave, menaxhimin e shpenzimeve, në shkarkim-ngarkim, në amballazhimin, kontrollin e cilësisë,vendosjen e etiketave, spacionin, faturimin, menaxhimin e të gjitha dokumentave te trasportit, asistencë për spacionin,menaxhimin e praktikave të dëmtimeve, te praktikave të stokut,te perpunimit të të dhenave,faturimin për llogari të treteve.

-Ngarkim shkarkim dhe spostim te mallit per te vete dhe te trete.

-Menaxhim i parkimit te automjeteve, kamioneve per te vete dhe te trete.

-Marketingu dhe reklamimi. Projektimi i faqes internet. Projektimi, zhvillimi dhe tregtimi i softwerit. Grafike dhe dizajn. Zyra e jashtme dhe Front Office. Nenkontrata e burimeve njerezore. Nenkontrata e sherbimeve te IT. Regjistrimi i te dhenave. Nxjerra e te dhenave. Pasurimi i te dhenave. Imazhi i dokumentit.Menaxhimi administrativ. Menaxhimi Financiar.Qendra e thirrjeve.

-Import Eksport tregtim artikuj te ndryshem industriale, si dhe te gjithe mallrave qe lidhen me aktivitetin e shoqerise.

-Aktivitet kontrollues dhe menaxhues per te trete si brenda dhe jasht vendit,

Për të vetmin qëllim të arritjes së objektit të lartpërmendor, shoqeria mund të blejë interesa, aksione, pjesëmarrje të kapitalit, në shoqeri të tjera, konsorciume ose kompani te cilat kane objekte te ngjashem apo analoge me te vetin dhe te kryeje te gjitha operacionet tregtare, industriale, financiare te nevojshme per permbushjen e qellimit te saj.. Ne vecanti, shoqeria, mund te marre ne pronesi, uzufrukt ose qera, kompani ose dege kompanish qe operojne ne fushen e nje ose me shume prej veprimitarive te mesiperme

Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë cdo lloj aktiviteti të parashikuar nga ligji në përputhje me rregullat e dispozitat në fuqi.

#### NENI 4

##### Selia e Shoqërisë

Shoqeria ka seline ligjore:

Durrës, Lagjja 17, Rruga Prokop Sorra, Godina nr.17, Hyrja 2

Shoqeria mund te hape filiale, dege apo perfaqesi ne te gjithe territorin shqiptar dhe jashte tij.

#### NENI 5

##### Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para i ortakut themelues të kësaj Shoqërie në lekë. Kapitali themeltar i shoqërisë eshte 100.000 Leke (njeqindmije)lekë dhe përbëhet nga 1 (nje) kuote.

Z. **NIKOLLAJ GJATA** është zotërues e 1 kuote, me 100 % pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë ne vleren 100.000 leke.

#### NENI 6

##### Kohëzgjatja e shoqërisë

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë është i papërcaktuar dhe fillon me regjistrimin e saj në QKB.

#### NENI 7

##### Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asamblea e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratorët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Organizimi dhe funksionimi i këtyre organeve është përcaktuar në statutin e shoqërisë. Shoqëria administrohet nga një Administrator, i cili do të zgjidhet **për një afat 5 vjecar**, me te drejte riemerimi.. Administratori i Shoqërisë do të jetë **Z. NIKOLLAJ GJATA**.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori, i cili do të ushtrojë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

#### NENI 8

Ortaku themelues mund të vendosi me vullnetin e tij, për pjesemarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijoje çdo lloj aktiviteti tjeter privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

#### NENI 9

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

#### NENI 10

Ortaku detyrohet të ruajë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

#### NENI 11

##### Legjislacioni i aplikuar

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i firmosur nga ortaket e Shoqerise . Cdo gjë që nuk është parashikuar në Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe nga dispozita ligjore në fuqi.

#### ORTAKU THEMELUES

**Z. NIKOLLAJ GJATA**

